



2023

01.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË****KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit**

**RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN****8/MUJORI I VITIT 2025****1. Baza ligjore**

Ky raport është hartuar në zbatim të kuadrit normativ në fuqi, konkretisht:

- **Ligji nr. 68/2017**, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”;
- **Ligji nr. 139/2015**, i ndryshuar, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- **Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008**, i ndryshuar, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- **Ligji nr. 115/2024, datë 03.12.2024**, “Për Buxhetin e vitit 2025”;
- **Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018**, i ndryshuar, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- **Vendimi i Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 25, datë 24.12.2024**, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”.

**2. Qëllimi i raportit**

Raporti paraqet rezultatet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për tete mujorin e 2025, duke vlerësuar:

- realizimin e të ardhurave nga burimet vetjake dhe transfertat;
- ecurinë e shpenzimeve sipas programeve dhe zërave ekonomike;
- ndikimin e menaxhimit financiar në cilësinë e shërbimeve të ofruara.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORË

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

### 3. Misioni i Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë:

1. Harton dhe zbaton politika rajonale, të harmonizuara me politikat kombëtare, në përmbushje të funksioneve të përcaktuara me ligj;
2. Koordinon dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet nivelit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore të rajonit;
3. Krijon partneritete me aktorë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, duke synuar zhvillimin socio-ekonomik të qëndrueshëm dhe përmirësimin e shërbimeve për komunitetin;
4. Merr pjesë aktive në programe ndërkufitare dhe iniciativa të financuara nga BE-ja, me fokus rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të ekonomisë vendore.

### 4. Objektivat kryesore për vitin 2025

- **Harmonizimi i politikave rajonale** me prioritetet kombëtare të zhvillimit;
- **Hartimi i Planit Sektorial** për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në territorin e qarkut;
- **Zgjerimi i pjesëmarrjes** në programe ndërkufitare dhe ndërrajonale për zhvillim të qëndrueshëm;
- **Nxitja e bashkëpunimit** midis njësive të qeverisjes vendore në rajon;
- **Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve** publike dhe forcimi i qeverisjes së mirë;
- **Rritja e kontributit** të qarkut në procesin e integritit evropian.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

#### 5. Burimet e financimit gjatë tetëmuorit 2025

Gjatë periudhës së raportimit, financimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut është mbështetur në këto kategori kryesore:

- **Të ardhurat vetjake** – të përbëra nga tarifat dhe shërbimet e miratuara me vendime të Këshillit të Qarkut;
- **Transferta e pakushtëzuar (granti i përgjithshëm)** – që garanton bazën e funksionimit të institucionit;
- **Transferta të kushtëzuara** – fonde të dedikuara për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve specifike, në përputhje me marrëveshjet e bashkëfinancimit dhe programet përkatëse.

Ky kombinim burimesh ka mundësuar mbajtjen e stabilitetit fiskal dhe përballimin e detyrimeve buxhetore në vijimësi.

#### 6. Realizimi i të ardhurave

Të ardhurat vetjake për periudhën janar–gusht 2025 janë planifikuar duke marrë në konsideratë:

- trendet historike të arkëtimeve në vitet e mëparshme;
- realizimi faktik i vitit 2024;
- pritshmëritë për rritje në shërbime dhe tarifa.

Rezultatet tregojnë një **nivel të qëndrueshëm të arkëtimeve**, i cili ka mundësuar mbështetjen e programeve prioritare dhe sigurimin e një bilanci mes nevojave të financimit dhe burimeve në dispozicion.

#### 7. Realizimi i shpenzimeve



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

Shpenzimet e kryera gjatë tetëmuorit janë menaxhuar në përputhje me planin vjetor të miratuar, duke respektuar:

- **orientimin e fondeve drejt projekteve dhe aktiviteteve prioritare**, sipas objektivave zhvillimore të Këshillit të Qarkut;
- **kufijtë buxhetorë dhe disiplinën fiskale**, në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- **procedurat e prokurimit publik**, duke garantuar transparencë, efikasitet dhe përdorim racional të fondeve.

Ky menaxhim ka siguruar financimin e aktiviteteve institucionale, programeve zhvillimore dhe projekteve me interes publik, duke ruajtur një performancë pozitive në raport me treguesit fiskalë të planifikuar.

Të ardhurat në buxhetin e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:


| Te ardhurat                                            | Plani 2025<br>8/mujor | Fakti 2025<br>8/mujor | Realizimi<br>ne % | Diferenca ne<br>leke |
|--------------------------------------------------------|-----------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| <b>1. Transferta e pakushtezuar</b>                    | <b>85,247,188</b>     | <b>85,247,188</b>     | <b>100%</b>       | <b>0</b>             |
| <b>2. Te ardhurat e veta</b>                           | <b>10,500,000</b>     | <b>6,477,100</b>      | <b>61%</b>        | <b>4,022,900</b>     |
| a. Te ardhura nga tarifat                              | 500,000               | 477,100               | 95%               | 22,900               |
| b. Te ardhurat nga kuota e antaresise                  | 10,000,000            | 6,000,000             | 60%               | 4,000,000            |
| <b>3. Te ardhura te trasheguara (Grant+te ardhura)</b> | <b>95,747,188</b>     | <b>91,724,288</b>     | <b>96%</b>        | <b>4,022,900</b>     |
| <b>4. Transferta e kushtezuar</b>                      | <b>24,425,578</b>     | <b>24,425,578</b>     | <b>100%</b>       | <b>0</b>             |
| a. DAMT                                                | 6,770,000             | 6,770,000             | 100%              | 0                    |
| b. Qendra Psiko Sociale Vatra                          | 17,655,578            | 17,655,578            | 100%              | 0                    |
| <b>TOTAL</b>                                           | <b>120,172,766</b>    | <b>116,149,866</b>    | <b>96%</b>        | <b>4,022,900</b>     |



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit



### *Analiza e realizimit të të ardhurave për 8-mujorin e parë të vitit 2025*

#### **. Transferta e pakushtëzuar (Granti i pakushtëzuar)**

Gjatë periudhës tetëmuajore të vitit 2025 është realizuar në shumën **85,247,188 lekë**, që përbën **70% të planit vjetor** për këtë kategori.

Kjo transfertë vazhdon të mbetet **burimi kryesor i financimit** të funksioneve të veta të Këshillit të Qarkut, duke mundësuar përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe financimin e aktiviteteve institucionale. Celja e saj është kryer sipas **planifikimit tremujor të buxhetit**, pa pasur ndryshime në vlerë gjatë periudhës raportuese.

#### **2. Të ardhurat vetjake të institucionit**

Gjatë tetëmuajorit janë arkëtuar **477,100 lekë**, ose **95% e planit 8-mujor**, duke rezultuar në një **diferencë prej 22,900 lekësh** në raport me planin fillestar.

Planifikimi i këtyre të ardhurave është bazuar në **tendencat e viteve të mëparshme**, megjithatë, për



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORË

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

shkak të natyrës së paqëndrueshme dhe të vështirë për t'u parashikuar të disa burimeve – si tarifat nga DAMT, urbanistika, etj. – janë evidentuar devijime në realizimin faktik.

### 3. Të ardhurat nga kontributet e bashkive

Në këtë periudhë janë arkëtuar **6,000,000 lekë**, që përbën **60% të planit 8-mujor**, të siguruar nga **kontributi i Bashkisë Vlorë**.

Këto të ardhura paraqesin një burim të rëndësishëm për financimin e projekteve në nivel rajonal, në përputhje me objektivat e përbashkëta të zhvillimit.

### 4. Përdorimi i të ardhurave të realizuara

Të ardhurat e siguruar gjatë periudhës janar–gusht 2025 janë përdorur në funksion të realizimit të programeve dhe detyrimeve ligjore, si më poshtë:

- **Paga dhe shpërblime** për personelin administrativ dhe funksionarët e zgjedhur/emëruar;
- **Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** për personelin;
- **Shpenzime operative** të domosdoshme për funksionimin e institucionit;
- **Investime në infrastrukturë**, të realizuara në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në propozimet e paraqitura nga bashkitë dhe të miratuara nga Këshilli i Qarkut.

### Të ardhurat nga fondet e kushtëzuara për vitin 2025

Gjatë periudhës së 8-mujorit të vitit 2025, Këshilli i Qarkut Vlorë ka përfituar fonde nga transfertat e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, në shumën totale prej 24,425,578 lekë. Këto fonde janë ndarë si më poshtë:



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

- 6,770,000 lekë si transfertë e kushtëzuar për mbulimin e funksionit të deleguar që lidhet me veprimtarinë e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark.
- 17,655,578 lekë si fond social për Qendrën Psiko-Sociale “Vatra”, akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me destinacion mbulimin e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ushqim.

Gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer asnjë ndryshim në vlerën ose strukturën e transfertave të kushtëzuara, të cilat janë përdorur në përputhje me destinacionin dhe funksionet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

### Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën janar–gusht 2025

#### Realizimi i shpenzimeve gjatë periudhës 8-mujore 2025

Gjatë periudhës janar–gusht 2025, shpenzimet e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë janë realizuar në shumën **73,499,357 lekë**, nga një total i planifikuar prej **95,747,188 lekë**, duke përbërë **77% të planit 8-mujor**.

Struktura e shpenzimeve është si më poshtë:

#### 1. Shpenzimet korrente

- Fondi i parashikuar për 8-mujorin: **5,313,938 lekë**
- Realizimi faktik: **5,313,938 lekë**
- Përqindja e realizimit: **100%**

Shpenzimet korrente janë përdorur kryesisht për:



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

- pagesën e detyrimeve operative të institucionit;
- likuidimin e kontratave të shërbimeve të rregullta;
- shpenzime të tjera të nevojshme për funksionimin e përditshëm të administratës.

#### 2. Shpenzimet kapitale

- Fondi i parashikuar për 8-mujorin: **44,974,750 lekë**
- Realizimi faktik: **26,952,830 lekë**
- Përqindja e realizimit: **60%**

Këto fonde janë përdorur për:

- **blerje orendish dhe pajisjesh** për mobilimin e ambienteve të Këshillit të Qarkut;
- **pagesën e dy situacioneve** për investimin:
  - *“Rikonstruktion i rrugëve të fshatit Aliban, Njësia Administrative Novoselë”.*

Shpenzimet kapitale janë zbatuar në përputhje me planifikimin dhe procedurat e prokurimit publik, duke garantuar transparencë dhe përdorim efikas të fondeve.

#### 3. Projektet me financim të huaj

- Të gjitha projektet me financim të huaj të trashëguara nga vitet e mëparshme janë **mbyllur brenda vitit 2024**.
- Për vitin buxhetor 2025 **nuk është parashikuar fond** për projekte të tilla.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË


### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

- Ky vit është periudhë e nënshkrimit të kontratave për projektet e reja, të cilat parashikohet të hyjnë në zbatim në vitin 2026.

| Nr.      | Emertimi sipas programeve         | Plan 8 mujor       | Fakt 8 mujor      | Diferenca         | % realizim |
|----------|-----------------------------------|--------------------|-------------------|-------------------|------------|
| <b>1</b> | <b>Administrata-Prog 01110</b>    | <b>95,747,188</b>  | <b>73,499,357</b> | <b>32,408,230</b> | <b>77</b>  |
|          | Paga (600)                        | 13,300,000         | 11,508,078        | 1,791,922         | 87         |
|          | Sigurime shoq/shend (601)         | 2,700,000          | 1,876,610         | 823,390           | 70         |
|          | Shpenzime operative (602)         | 5,313,938          | 5,313,938         | 0                 | 100        |
|          | Transferta te brendsheme (604)    | 17,958,500         | 17,525,500        | 433,000           | 98         |
|          | Transferta te jashteme (605)      | 500,000            | 201,899           | 298,101           | 49         |
|          | Fond I vecante (609)              | 1,000,000          | 0                 | 1,000,000         | 0          |
|          | Investime (231)                   | 44,974,750         | 26,952,830        | 18,021,920        | 59         |
| <b>2</b> | <b>DAMT-Prog 01160</b>            | <b>6,770,000</b>   | <b>5,635,815</b>  | <b>1,134,185</b>  | <b>83</b>  |
|          | Paga (600)                        | 5,595,000          | 4,810,252         | 784,748           | 86         |
|          | Sigurime shoq/shend (601)         | 965,000            | 741,105           | 223,895           | 77         |
|          | Shpenzime operative (602)         | 300,000            | 84,458            | 125,542           | 40         |
| <b>3</b> | <b>Qendra Psiko Sociale Vatra</b> | <b>17,655,578</b>  | <b>11,021,427</b> | <b>6,634,151</b>  | <b>62</b>  |
|          |                                   |                    |                   |                   |            |
|          | <b>TOTAL</b>                      | <b>120,172,766</b> | <b>90,156,599</b> | <b>40,176,566</b> | <b>75</b>  |

Grafiku i Realizimit 8-mujor





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

#### Analiza analitike e shpenzimeve për Administratën – 8-mujori 2025

(Programi 01110: Administrimi i Këshillit të Qarkut)

Gjatë periudhës janar–gusht 2025, **buxheti i miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut Vlorë** është realizuar në masën **77%**, me një vlerë totale shpenzimesh prej **73,499,357 lekë**, nga **95,747,188 lekë** të planifikuara.

Menaxhimi i buxhetit është kryer në përputhje me programimin e miratuar, duke ruajtur një **raport të qëndrueshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve** dhe duke respektuar **limitin e pagesave** të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Gjatë kësaj periudhe nuk janë konstatuar devijime financiare apo detyrime të papaguara.

#### 1. Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore (Artikujt 600 + 601)

Realizimi i shpenzimeve për pagat dhe kontributet shoqërore është kryer në përputhje me **strukturën organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut**.

Administrata aktualisht përbëhet nga **13 punonjës (10 civilë dhe 3 të zgjedhur/emëruar)**, të cilët paguhen sipas nivelit të pagave të miratuara dhe me financim nga **transferta e pakushtëzuar e vitit 2025**.

- **Fondi i realizuar për këtë periudhë:** 11,508,078 lekë
- **Fondi i planifikuar për 8-mujorin:** 13,300,000 lekë
- **Përqindja e realizimit:** 87%

Këshilli i Qarkut ka përmbushur në kohë të gjitha detyrimet ligjore për pagat dhe kontributet shoqërore, pa lënë asnjë detyrim të pashlyer.

#### 2. Shpenzime operative dhe këshilltare (Artikulli 602)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

Shpenzimet operative janë kryer në funksion të mbështetjes së aktiviteteve të institucionit, në përputhje me programet e miratuara nga Këshilli i Qarkut. Realizimi i këtyre shpenzimeve ka përfshirë:

- furnizime të nevojshme për funksionimin e administratës;
- mbështetje për aktivitetet zyrtare dhe institucionale të planifikuara.
- **Fondi i realizuar:** 5,313,938 lekë
- **Fondi i planifikuar (vetëm për programin 01110):** 5,313,938 lekë
- **Përqindja e realizimit:** 100%

Per kete periudhe kohore eshte ezauruar i gjithe fondi i planifikuar.

### 3. Shpenzimet për transfertat e brendshme (Artikulli 604)

Gjatë 8-mujorit të vitit 2025, në këtë artikull janë përfshirë transfertat e planifikuara për:

- **Shoqatat e të Verbërve të Qarkut Vlorë, dhe**
- **Transferta për investime në bashki, konkretisht:**

Këshilli i Qarkut ka transferuar fondin e parashikuar për një investim të planifikuar në **Bashkinë Konispol**, në vlerën **20,458,500 lekë**, në përputhje me vendimet e miratuara dhe marrëveshjet ndërinstitucionale.

Ky ndryshim përfaqëson një praktikë të re, ku për investime të natyrës lokale preferohet transferimi i fondit për realizimin nga njësia përkatëse.

### 4. Shpenzimet kapitale (Investime) – Artikujt 230–231

Për periudhën në fjalë, janë prokuruar dhe likujduar dy investime:



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI I QARKUT VLORE

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit

- Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim të ambjenteve të Keshillit të qarkut me vlerën 1,724,668 leke;
- “Rikonstruktion i rrugeve të fshatit Aliban, Njesia Administrative Novosele” prokuruar në vlerën 26,176,032 leke dhe paguar dy situacione në vlerën 23,966,754 leke.

#### 5. Shpenzimet për funksionet e deleguara – DAMT

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark (DAMT) operon si funksion i deleguar nga niveli qendror dhe financohet përmes **transfertës së kushtëzuar** të dhënë nga buxheti i shtetit.

##### 5.1 Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (Artikujt 600–601)

- Numri aktual i punonjësve: 5 nga 7 pozicione të planifikuara
- Pozicione vakante: 2
- Realizimi i fondit për paga dhe sigurime: 5,551,357 lekë
- Fondi i planifikuar: 6,560,000 lekë
- Përqindja e realizimit: 83%

Shpenzimi është më i ulët se plani vjetor për shkak të **mungesës së dy punonjësve** dhe **mosaktivizimit të fondit të veçantë për to**.

##### 5.2 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (Artikulli 602)

- Fondi i planifikuar: 210,000 lekë
- Realizimi aktual: 84,458 lekë

Shpenzimet e kryera lidhen vetëm me **kostot e energjisë elektrike dhe dietave**, ndërkohë që pjesa tjetër e shpenzimeve do të realizohet në periodat në vijim, në varësi të ecurisë së aktivitetit të drejtorisë.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË****KËSHILLI I QARKUT VLORE**

**Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social  
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,  
Politikave Sociale dhe Turizmit**

**6. Shpenzimet për funksionin e deleguar – Qendra Psiko-Sociale “Vatra”**

Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar shpenzimet për pagat, sigurimet dhe ushqimin për punonjësit e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”, në kuadër të transfertës së kushtëzuar të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Shpenzimet e realizuara: 11,021,427 lekë
- Fondi i planifikuar vjetor: 17,655,578 lekë
- Përqindja e realizimit: 62%

Përdorimi i fondeve është kryer në përputhje me destinacionin dhe strukturën e miratuar, në respektim të kërkesave të programit dhe nevojave të qendrës.

Drejtor

Anisa HYSENI

KRYETARI

Ervis Moçka

